

# KUJDES!

- Mos harroni të kodoni grupin (A ose B) në fletëpërgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të kodohet me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta kodoni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

Saktë  A  B  C  D

Gabim  A  B  C  D

- Bëni kujdes për të mos dalë jasht rrethit kur të kodoni përgjigjen.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si zhgarravitje, rrudhosje etj.
- Mos iu përgjigjini pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 3 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **150 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan "PERGJIGJET".
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Kodoni me kujdes preferencat tuaja për shkollat në të cilat dëshironi të studioni. Rezultatet dhe bursat do të shpallen sipas preferencave të bëra.

Shkolla	Kodi
"Mehmet Akif" e Mesme - Vajza në Tiranë (me konvikt)	<b>01</b>
"Mehmet Akif" e Mesme - Djem në Tiranë (me konvikt)	<b>02</b>
"Turgut Özal" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Tiranë (me konvikt)	<b>03</b>
"Hasan Riza Pasha" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Shkodër (e mesme me konvikt)	<b>04</b>
"Turgut Özal" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Durrës (klasat 9-12 me konvikt)	<b>05</b>

*Suksese!*

**1.**

Gjeni vlerën e  $x$  në ekuacionin e mëposhtëm.

$$|2x - 5| - 2 = 7$$

- A)  $\{-2; 7\}$
- B)  $\{2; 7\}$
- C)  $\{-7; 2\}$
- D)  $\{-7; -2\}$

**2.**

Thjeshtoni shprehjen  $\frac{(x^6 \cdot y^4)^2}{(x^3 \cdot y^2)^{-4}}$

- A)  $x^{12}y^8$
- B)  $x^{24}y^{16}$
- C)  $x^{16}y^{24}$
- D)  $x^2y^2$

**3.**

Gjeni vlerën e  $x$  nëse  $3^{3x-5} = 81$ .

- A) 6
- B) 5
- C) 4
- D) 3

**4.**

Kryeni veprimet

$$(\sqrt{2})^4 + (\sqrt{5})^4 - (\sqrt{5})^2 - (\sqrt{2})^6$$

- A) 15
- B) 16
- C) 17
- D) 18

**5.**

Faktorizoni shprehjen:  $x^2 - xy - 3x + 3y$

- A)  $(y - x)(x - 3)$
- B)  $(x - y)(x - 3)$
- C)  $(3 - y)(x - 3)$
- D)  $(x - y)(y - 3)$

**6.**


Thjeshtoni shprehjen  $\frac{4x^4y^3}{x^2 - 9} : \frac{2x^3y^2}{3 - x}$

- A)  $\frac{2xy}{x+3}$
- B)  $\frac{xy}{x+3}$
- C)  $\frac{-2xy}{x+3}$
- D)  $\frac{4xy}{x-3}$

**7.**

Në figurën e dhënë gjeni vlerën e  $x$ .


- A) 14
- B) 15
- C) 16
- D) 17



**8.**

Në figurën e dhënë gjeni vlerën e  $x$ .

- A) 3
- B)  $2\sqrt{3}$
- C)  $\sqrt{3}$
- D)  $3\sqrt{3}$



**9.**


Në figurën e dhënë jepen

$$m(\angle BAC) = m(\angle DBC),$$

$$|AB| = 4 \text{ cm}, |BD| = 3 \text{ cm} \text{ dhe } |BC| = 8 \text{ cm}$$

Sa është  $|DC| = x$  në cm?

- A) 6
- B) 8
- C) 10
- D) 12




**10.**

ABCD është një paralelogram,

$$|AB| = 21 \text{ cm}, |AD| = 14 \text{ cm}, |DE| = 6 \text{ cm}.$$

Gjeni vlerën e  $x$ .

- A) 6
- B) 7
- C) 8
- D) 9




**11.**

ABCD është një trapezoid dybrinjëshëm

$$|DC| = 6 \text{ cm}, |AB| = 12 \text{ cm} \text{ dhe } m\angle B = 60^\circ$$

Gjeni sipërfaqen e trapezoidit.

- A)  $18\sqrt{3} \text{ cm}^2$
- B)  $27 \text{ cm}^2$
- C)  $27\sqrt{3} \text{ cm}^2$
- D)  $36 \text{ cm}^2$



**12.**

Nëse  $\begin{cases} 2x + y = 8 \\ 3x - 2y = -2 \end{cases}$  atëhere gjeni vlerën e

$$x + y .$$

- A) 6
- B) 8
- C) 10
- D) 12

**13.**

Gjeni zgjidhjen e mosbarazimit të mëposhtëm:

$$3(x-1) - 2(x+3) < 3 - 2x$$

A)  $x < 2$

B)  $x < 3$

C)  $x < 4$

D)  $x < 5$

**14.**

Jepet bashkësitë  $A = ]-1; 3]$ ,  $B = [0; 4[$  gjeni  $A \cap B$ .

A)  $A \cap B = [0; 3]$

B)  $A \cap B = [-1; 4]$

C)  $A \cap B = [0; 3[$

D)  $A \cap B = ]-1; 0]$

**15.**

Një baba dhe djali i tij janë respektivisht 49 dhe 9 vjeç. Mbas sa vjetësh babai do të ketë trefishin e moshës së djalit të tij?

A) 11

B) 12

C) 13

D) 14

**16.**

Jepet ekuacioni  $x^2 - 4x - 8 = 0$  me rrënjë  $x_1$  dhe  $x_2$ . Gjeni vlerën e shprehjes  $\frac{1}{x_1} + \frac{1}{x_2}$ .

A) -2

B)  $\frac{1}{2}$

C)  $-\frac{1}{2}$

D)  $\frac{3}{2}$

**17.**

Gjeni bashkësinë e zgjidhjeve të ekuacionit

$$\frac{x^2 - 3x}{4} = 1 .$$

- A) {1; 4}
- B) {-1; 4}
- C) {-4; 1}
- D) {-3; 4}

**18.**

Jepet  $\frac{x}{y} = 3$ , gjeni vlerën e shprehjes  $\frac{2xy}{x^2 + y^2}$ .

- A)  $\frac{3}{5}$
- B)  $-\frac{3}{5}$
- C)  $\frac{5}{3}$
- D)  $-\frac{5}{3}$

**19.**

Kryeni veprimet  $\frac{5}{0,5} - \frac{4}{0,25} + \frac{1}{0,125}$

- A) 0
- B) 2
- C) 4
- D) 6


**20.**

Kryeni veprimet  $\sqrt{\frac{3}{8}} + \sqrt{2 + \frac{1}{4}}$

- A)  $\frac{3}{2}$
- B)  $\sqrt{\frac{5}{4}}$
- C)  $\sqrt{\frac{15}{8}}$
- D)  $\sqrt{\frac{8}{15}}$

**21.**



Cili numër vjen në vend të pikëpyetjes?



- A) 4      B) 6      C) 8      D) 9

**22.**

Cili numër vjen në vend të  $x$ ?



- A) 28      B) 31      C) 33      D) 37

**23.**


Cila figurë është ndryshe nga të tjerat?



- A)      B)      C)      D)

**24.**


Cila figurë formohet nga bashkimi i dy figurave të mëposhtme?



- A)      B)      C)      D)

**25.**


Numrat brenda figurave janë vendosur sipas një rregulli të caktuar. Cili numër vjen në vend të pikëpyetjes?



- A) 4      B) 8      C) 12      D) 16

26.



Cili numër vjen në vend të pikëpyetjes?



- A) 6      B) 7      C) 8      D) 9

27.



Cila figurë vjen më pas?



- A)      B)      C)      D)

28.

Cila figurë vjen më pas?





- A)      B)      C)      D)

29.


Cila figurë plotëson vendet bosh?

1	3	5	7
4	8	?	16
7	?	19	25
10	18	?	34



30.

Cila figurë është ndryshe nga të tjerat?



- A)      B)      C)      D)

**31.**

Sasia e nxehtësisë së përthithur nga një trup prej bakri me masë 100 g në temperaturë 25°C është 1800 cal. Sa është temperatura përfundimtare e trupit ? ( $c_{\text{bakrit}} = 0,09 \text{ cal/g}^\circ\text{C}$ )

- A) 200°C
- B) 225°C
- C) 250°C
- D) 275°C

**32.**

Kur një trup pluskon në ujë, 25% e vëllimit të tij qëndron mbi sipërfaqen e ujit. Sa është densiteti i trupit kur dimë që  $d_{\text{ujit}} = 1000 \text{ kg/m}^3$  ?

- A) 650 kg/m<sup>3</sup>
- B) 750 kg/m<sup>3</sup>
- C) 700 kg/m<sup>3</sup>
- D) 800 kg/m<sup>3</sup>


**33.**

Një gaz në temperaturën 127°C ushtron një shtypje prej 20 atm. Në qoftë se shtypja trefishohet në kushtet e vëllimit konstant, sa do të jetë temperatura përfundimtare e gazit?

- A) 827°C
- B) 1200°C
- C) 927°C
- D) 1127°C

**34.**


Masa e kuboidit të treguar në figurë është 3600 kg. Sa është shtypja që ushton trupi mbi tokë?



- A) 3000 N/m<sup>2</sup>
- B) 23000 N/m<sup>2</sup>
- C) 29000 N/m<sup>2</sup>
- D) 24500 N/m<sup>2</sup>

**35.**

Një insekt lëviz nga qendra e rrethit në pikën P dhe pastaj në pikën R. Sa është zhvendosja e insektit?




- A) r
- B) r + s
- C) s - r
- D) 2r



36.

Një trup me masë  $m$  lëshohet nga prehja nga një lartësi  $1.8m$ . Sa është shpejtësia me të cilën trupi prek tokën? ( $g = 10 \text{ N/kg}$ )



- A) 50 m/s
- B) 40 m/s
- C) 6 m/s
- D) 5 m/s


37.

Një enë në formë kubi me brinjë  $2\text{cm}$  është e mbushur përgjysëm me ujë. Kur një gur hidhet në enë, niveli i ujit në të rritet me  $0.5\text{cm}$ , ndërsa masa totale e enës bëhet  $8\text{g}$ . Sa është densiteti i gurit në  $\text{g/cm}^3$ ? ( $d_{\text{ujit}} = 1\text{g/cm}^3$ )

- A) 4
- B) 3
- C) 2
- D) 1

38.

Cili prej qarqeve të mëposhtëm është i ndërtuar saktë?



39.

Një rreze bie mbi pasqyrën e treguar në figurë. Sa është këndi i reflektimit të kësaj rrezeje?

- A)  $10^\circ$
- B)  $20^\circ$
- C)  $30^\circ$
- D)  $60^\circ$



40.

Një hekur hekurosje me fuqi  $1200\text{W}$  punon  $5$  orë në javë. Sa është energjia e shpenzuar në  $\text{kWh}$  për  $10$  javë?

- A) 20 kWh
- B) 40 kWh
- C) 60 kWh
- D) 80 kWh


41.

Gjeni formulën molekulare të alkanit në të cilin raporti midis masës së hidrogjenit dhe masës së karbonit është 4/21. (C:12 g/mol, H:1 g/mol)

- A)  $C_6H_{14}$
- B)  $C_5H_{12}$
- C)  $C_7H_{16}$
- D)  $C_4H_{10}$

42.

Sa është sasia e nxehtësisë së çliruar kur në reaksion hyjnë 5.6 gram azot?



- A) 9.2 kJ
- B) 18.4 kJ
- C) 4.6 kJ
- D) 46 kJ


43.

Cila prej përbërjeve të mëposhtme është acid?

- A)  $H_2O$
- B)  $HCl$
- C)  $CH_4$
- D)  $NH_3$

44.

Cili është emërtimi i saktë i kësaj strukture?



- A) Hekzan
- B) Dimetil-2,3-butan
- C) Trimetil-2,2,2-butan
- D) Dimetil-2,2-butan

45.

Sa mililitër ujë duhet ti shtohen 100 ml tretësire HCl 0.2 M për ta bërë përqëndrimin e saj 0.1 M?

- A) 20 ml
- B) 50 ml
- C) 100 ml
- D) 150 ml

46.

Gjeni përqindjen në masë të karbonit në molekulën e glukozës  $C_6H_{12}O_6$ . (C:12 g/mol, H:1 g/mol, O:16 g/mol)

- A) 30 %
- B) 40 %
- C) 50 %
- D) 20 %

47.

Cilat prej të mëposhtmeve janë të sakta?

- I. pH=4, mjedis acidik
- II. pH=12, mjedis acidik
- III. pH=6, mjedis bazik
- IV. pH=10, mjedis bazik

- A) II dhe III
- B) II dhe IV
- C) III dhe IV
- D) I dhe IV

48.

Gjeni formulën empirike të një përbërje që përmban 3.2 gram sulfur dhe 4.8 gram oksigjen. (S:32 g/mol, O:16 g/mol)

- A) SO
- B) SO<sub>2</sub>
- C) SO<sub>3</sub>
- D) SO<sub>4</sub>


49.

Cila prej përbërjeve të mëposhtme **nuk është** kripë?

- A) MgCl<sub>2</sub>
- B) Na<sub>2</sub>SO<sub>4</sub>
- C) Al(NO<sub>3</sub>)<sub>3</sub>
- D) NH<sub>3</sub>

50.

Gjeni masën e ujit të prodhuar nga reaksioni i 8 gram hidrogjen me 32 gram oksigjen. (H:1 g/mol, O:16 g/mol)



- A) 18 g
- B) 36 g
- C) 16 g
- D) 8 g

51.

Cila nga karakteristikat e mëposhtme nuk është e vërtetë për organizmat në përgjithësi?

- A) Organizëm qelizor
- B) Prodhim ernalgjie - ATP
- C) Fotosinteza
- D) Ekskretimi

52.

Rrjeti Endoplazmatik i ashpër (kokrrizuar) ka këtë emër si pasojë e pranisë së \_\_\_\_\_ mbi të.

- A) Ribosomeve
- B) Mitokondrive
- C) Lizosomeve
- D) Trupave (aparateve) të Golxhit

53.

Aparati i Golxhit ka funksion :

- A) Paketimin e proteinave nëpër vezikula
- B) Modifikimin e proteinave
- C) Prodhimin e lizosomeve
- D) Te gjitha funksionet e listuar më sipër

54.

Cila nga karakteristikat e listuara më poshtë **nuk** është e vërtetë për membranën qelizore?

- A) Përbëhet vetëm nga një shtresë fosfolipidesh
- B) Mbështjell qelizën dhe mban bashkë strukturat e saj
- C) Ka aftësi përzgjedhëse dhe rregullon kalimin e materialeve nëpërmjet saj
- D) Ka shumë lloje proteinash të zhytura në të

55.

Lëvizja e grimcave nga një vend me përqëndrim më të madh tek një më të ulët quhet:

- A) Osmozë
- B) Difuzion
- C) Filtrim
- D) Transport aktiv

56.

Cili është funksioni kryesor i ADN-së?

- A) Përmban informacion për sintezën e proteinave
- B) Mund të ndryshohet (mutacionet)
- C) Drejton procesin e sintezës së proteinave
- D) Prodhon energjinë për qelizën (ATP)

**57.**

Shkëmbimi i gazeve tek gjethja e bimës bëhet përmes:

- A) Gojzave
- B) Gropëzave
- C) Gypave të ajrimit
- D) Spirakujve

**58.**

Cila pjesë e bimëve me lule thith ujin e mineralet?

- A) Lulja
- B) Kërçelli
- C) Degët
- D) Rrënja

**59.**

Cila përshkruan më saktë hapat e ciklit qelizor dhe mitozës?

- A) Profazë, anafazë, interfazë, metafazë, telofazë
- B) Interfazë, profazë, metafaze, anafazë, telofazë
- C) Interfazë, metafazë, anafazë, telofazë, profazë
- D) Anafazë, profazë, telofazë, metafazë, interfazë

**60.**

Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i vërtetë për ARN-në?

- A) Përmban ribulozën si sheqer
- B) Ka tipe të ndryshme si mARN, tARN dhe rARN
- C) Është dy fijezore
- D) Përmban adeninë, guaninë, citozinë e uracil

**61.**

Gjeni fjalën e shkruar gabim:

- A) E diel
- B) Diell
- C) Diellor
- D) Mjell

**62.**

Në cilën nga fjalitë është përdorur koha e ardhme e së shkuarës e mënyrës dëftore:

- A) Po të kisha ngrënë mëngjes, ndoshta nuk do të kisha marrje mendsh.
- B) Nëse do të mësoja më shumë, do të dilja mirë në provim.
- C) Mendoja se do të dilja më mirë në provim.
- D) Po të binte shi, nuk do të vija në ekskursion.

**63.**Grupi i fjalëve “*jam + mbiemër; jam + emër*”, është:

- A) Kallëzues emëror
- B) Kallëzuesor
- C) Përcaktor
- D) Rrethantor

**64.**

Në cilën fjali është përdorur gabim nyja:

- A) Bredhat e rinj nuk e prishnin bukurinë e së tërës.
- B) Në atë moment iu kujtuan fjalët e të bijës.
- C) I ra një leckë tryezës së re.
- D) Kujtimet e së kaluarës do ta ndiqnin kudo atë.

**65.**

Në cilat rasa dalin trajtat e shkurtra:

- A) emërore + dhanore
- B) dhanore + kallëzore
- C) gjinore + rrjedhore
- D) emërore + rrjedhore

**66.**Në cilën nga fjalitë e mëposhtme “**u-ja**”, është përdorur si pjesëz e formës joveprore:

- A) U thashë të vinin me shpejtësi.
- B) Afërdita u zemërua me Narcisin dhe e ndëshkoi.
- C) U dukej sikur bridhnin nëpër qiell.
- D) Mesazhet e veprave u bënë ballë mijëravjeçarëve.

**67.**

Në cilën nga fjalitë e dhëna kemi të përdorur folje gjysmëndihmëse modale:

- A) Mundi shokun e tij në kampionatin e shahut.
- B) Do parë mirë kjo punë.
- C) I duhej një libër, por nuk po e gjente dot.
- D) Donte që të vinte, por nuk kishte kohë.

**68.**

Në fjalinë: *“De Rada thoshte që shqiptarët duhet të ruajnë gjuhën e tyre që të mos e shuajnë erërat e armikut.”*, pjesët e nën-renditura i kemi:

- A) përcaktore + qëllimore
- B) filluese + qëllimore
- C) filluese +shkakore
- D) përcaktore + shkakore

**69.**

Cila fjali e ka të shkruar saktë përemrin vetor dhe trajtën e shkurtër të tij:

- A) U tregova juve.
- B) I mora fletoren atyre.
- C) I dhashë porosinë atij.
- D) U tregua gjithë e vërteta.

**70.**

Në cilën fjali folja “jam”, ka kuptim të plotë:

- A) Ne jemi të mësuar me këtë gjë tani.
- B) Ju keni qenë gjithmonë gati për punë.
- C) Ti je djalë i zgjuar dhe e kupton këtë.
- D) Vajza është menduar gjithë ditën për fjalët që i the.

**71.**

Rretho alternativën e saktë: *“Cili nga grupet e mëposhtme bën pjesë tek format elementare të rrëfimit.”*:

- A) miti, përralla, tregimi, poezia
- B) fabula, legjenda, miti, përralla
- C) romani, tregimi, novela,
- D) miti, romani, tregimi, poema

**72.**

Personazhet e Stresit, Marashit, Gjergj Aranitit i gjejmë në veprën:

- A) “Prilli i thyer”
- B) “Ne të tre”
- C) “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”
- D) “Krastakraus”

73.

Në cilën poezi: *“Trishtimi i poetit nis me kometën që humbi në qiell dhe mbaron me boçen e karafilit të porsaçelur..”* :

- A) “Kadenca e violës”
- B) “Një vajzë”
- C) “Pa ty”
- D) “Bregu i mollës”

74.

*“Mbështetet në rrëfimet fantastike popullore dhe synon të afrojë jetën e përtej varrit me jetën e të gjallëve.”*, pjesa:

- A) “Ai...”
- B) “Rinë Katerinëza”
- C) “Narcizi”
- D) “Jesminë”

75.

Muji dhe Halili, janë personazhe të:

- A) Eposit homerik
- B) Eposit të kreshnikëve
- C) “Iliadës”
- D) Përrallave shqiptare

76.

Autori që rrëfen për jetën e vështirë në burgjet komuniste është:

- A) Mehdi Frashëri
- B) Edit Durham
- C) At Zef Pllumi
- D) Fan S. Noli

77.

I përket letërsisë arbëreshe:

- A) Lukreci
- B) Naim Frashëri
- C) Gjergj Fishta
- D) Jeronim de Rada

78.

*“Bashkëvendosja e dukurive të natyrës me ngjarje të jetës njerëzore që kanë lidhje ngjashmërie.”*, lidhet me figurën letrare të:

- A) epitetit
- B) metaforës
- C) paralelizmit figurativ
- D) simbolit



**79.**

Hëna shfaqet si figurë e përmbysur në poezinë:

- A) “Pa ty”
- B) “Një vajzë”
- C) “Diej që perëndojnë”
- D) “Mbresat e rrugëve”

**80.**

Janë shkruar nga Ndre Mjeda veprat:

- A) “Juvenilja”, “Andrra e jetës”, “Vaji i bylbylit”, “Liria”
- B) “Bagëti e bujqësi”, “Lulet e verës”, “Histori e Skënderbeut”
- C) “Lahuta e malcis”, “Mrizi i zanave”, “Gjuha shqipe”
- D) “Këngët e Milosaos”, “Serafina Topia”, “Flamuri Arbrit”

